



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:070627

Datë: 11.03.2019

Numri i dokumentit: 00242673

PKr.DKr.01/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti për Krime të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues Agim Ademi, me zyrtaren ligjore Xhemile Bejtullahu, në lëndën penale kundër të akuzuarës T. G., nga fshati Shillovë, Komuna e Gjilanit, të cilën sipas autorizimit e mbron avokati Afrim Salihu, nga Gjilani, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.268/18, të datës 26.12.2018, të cilën e përfaqëson prokurori Shaban Spahiu, pas mbajtjes së seancës mbi pranimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe të sanksionit penal, më datë 07.03.2019 mori dhe në prezencën e prokurorit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të saj publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara T. G. nga i ati dhe e ema e lindur, e lindur me dt., ne Nish, R, e Serbise, me vendbanim ne Nish por edhe ne fshatin Shillove, K, e Gjilanit, e martuar, nene e nje femiu, e punësuar ne kafiterine ,,, ne fshatin Shillovë, ka te kryer shkollën e mesme te mjeksisë, e gjendjes se mesme ekonomnike, Serbe, Shtetase e Republikës së Serbise, me numër personal:

Ë S H T Ë F A J T O R E

Se në kohë të pa vërtetuar e deri me datën 09.12.2018, në fshatin Shillovë, përkatësisht në lokalit bar kafiterinë „, ku e njëjta punon si menaxhere dhe këngëtare, ka siguruar dhe mbajtur në pronësi pa leje valide armët e ftohta, përkatësisht dy spreja piper neutralizues , te llojit „Loreal men expert,, dhe „ Sabre Red,, dhe nje shufër metalike, të cilat me datën e lartëcekur janë gjetur dhe sekuestruar nga ana e pjesëtarëve të policisë se Kosovës.

- Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës.

Prandaj Gjykata duke iu referuar marrëveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë, të akuzuarës T. G., në bazë të neneve 3, 41, 43, 46, 62, par.2. pika 2.7 dhe 374 par. 3 të KPRK-ës, si dhe neneve 233, 365 dhe 453 të KPPRK-ës,

E G J Y K O N

Me dënim me gjobë në lartësi prej 150 (njëqindpesëdhjetë) euro, të cilin dënim me gjobë e njëjta do ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, duke iu llogaritur 20 euro për një ditë burgimi.

Të akuzuarit i shqiptohet edhe dënim plotësues konfiskimi i armës: pistoletë të llojit “EKOl Special”, 99.9 mm, me numër serik EA- 18040413.

Obligohet e akuzuara që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 40 (katërdhjetë) euro dhe shpenzimet tjera sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, si dhe 50 (pesëdhjetë) euro për viktimat e krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzë PP.I.nr.268/2018, të datës 17.12.2018, ndaj të akuzuares T. G., nga fshati Shillovë, Komuna e Gjilanit, T. G., nga fshati Shillovë, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, Shaban Spahiu në seancën lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal të mbajtur më datë 07.03.2019, mbeti në tërësi pranë aktakuzës së ushtruar me shkrim dhe marrëveshjes për pranimin e fajësisë të arritur me datë 07.02.2019, e cila i është deponuar në Gjykatë më datë 08.02.2019, bazuar në dispozitën e nenit 233 të KPPRK-ës.

Përfaqësuesi i akuzës – prokurori Shaban Spahiu e ka njoftuar kryetarin e trupit gjykues të kësaj çështje për lidhjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë pasi që fillimisht është marrë pëlqimi nga kryeprokurori, me ç’ rast gjykatës ja kemi rekomanduar edhe dënimin, e duke hequr dorë nga dëgjimi i dëshmitarëve dhe shtjellimi i provave materiale.

Mbrojtësi i të akuzuarës, avokat Afrim Salihu, po ashtu ka njoftuar kryetarin e trupit gjykues të çështjes për marrëveshjen për pranimin e fajësisë me përfaqësuesin e akuzës e në prezencë të të akuzuarit, duke përfshirë edhe rekomandimin për sanksionin penal. Andaj, propozoi që marrëveshja të aprovohet sipas negocimit edhe sa i përket lartësisë së dënimit.

E akuzuara T. G. deklaroi se është e vërtetë se kemi arritur marrëveshje në Prokurorinë e Shtetit dhe jemi pajtuar edhe sa i përket dënimit të rekomanduar dhe propozoj që kjo marrëveshje si e tillë të aprovohet nga gjykata.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë përmbante të gjitha faktet, duke bërë propozim për marrëveshjen e pranimit të fajësisë, duke e njoftuar të akuzuarën me të drejtat dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke dhënë deklaratë me shkrim se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se këtë marrëveshje e ka bërë në mënyrë vullnetare.

Gjykata ka gjetur se e akuzuara ka bërë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal mbështetur në nenin 233 të KPPRK, dhe e njejta marrëveshje ishte në përputhje me kushtet e parapara me pikën 12 të këtij neni.

Gjykata, bazuar në marrëveshjen për pranimin e fajësisë si dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës, edhe atë: formulari pronë dëshmie me konfiskimin e armëve dhe foto dokumentacioni nga shkresat e lëndës është vërtetuar se e akuzuara T.

G. në kohë të pa vërtetuar e deri me datën 09.12.2018, në fshatin Shillovë, përkatësisht në lokalit bar kafiterinë „.....”, ku e njëjta punon si menaxhere dhe këngëtare, ka siguruar dhe mbajtur në pronësi pa leje valide armët e ftohta, përkatësisht dy spreja piper neutralizues, të llojit „Loreal men expert”, dhe „Sabre Red”, dhe një shufër metalike dhe në këtë mënyrë e ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-së.

Në seancën për negociimin dhe arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë përfaqësuesi i akuzës, e akuzuara dhe mbrojtësi i saj janë marrë vesh edhe lidhur me sanksionin penal. Gjykata ka aprovuar marrëveshjen si të tillë e njëkohësisht edhe propozimin nga marrëveshja për sanksionin penal, ashtu që të akuzuarës T. G., të i shqiptohet dënim me gjobë në lartësi prej 150 (njëqindëpesëdhjetë) euro të cilin dënim me gjobë e njëjta do ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim, duke ju llogaritur 20 euro për një ditë burgimi.

Vendimi për dënimin plotësues konfiskimi armeve të ftohta, dy spreja piper neutralizues, të llojit „Loreal men expert”, dhe „Sabre Red”, dhe një shufër metalike, është bazuar në nenin 374 par 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është bazuar në nenin 453 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 01/2019 të dates 07.03.2019**

Zyrtare ligjore,
Xhemile Bejtullahu

Kryetari i trupit gjykues,
Agim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.